



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 21 maj 2020, në mbledhjen e XXIV-të (njëzet e katër), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhës, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Avni Fetahu, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica (me përjashtim të ish dy anëtarëve, *Floretë Zejnullahu dhe Fitim Haziri të cilët janë zgjedhë Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës*).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje, ndër të tjera shtoi, besoj që thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj mund të fillojmë me punë.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me rendin e propozuar të ditës.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, theksoi, kur është përgatitur thirrja për këtë seancë kemi pasë në planifikime që të përfshihet edhe një pikë në kuadër të rendit të ditës, mirëpo disi është përvjedhur, andaj kërkoj nga ju anëtarët e këtij Komiteti që ta mbështetni që pika të cilën do të paraqes tani të përfshihet në kuadër të rendit të propozuar të ditës. Fjala është që në aspektin juridik ta kemi një plotësim ndryshim të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës, përkatësisht bëhet fjalë për datën e hyrjes në fuqi të Rregullores në fjalë, e cila parasheh edhe inkasimin e mjeteve financiare të cilën e merr Komuna e që për shkaqe të shumta hyrja në fuqi është e nevojshme të shtyhet. Andaj propozoj që kjo propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave të hyn në rend të ditës, pastaj kur t'i vie radha do të japim sqarimet tjera të nevojshme dhe do të diskutojmë më në detaje.

Pas votimit, njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, përfshirë edhe pikën shtesë, dhe atë;

- **Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës** (e cila hyn sipas radhës në pikën 4)

1. Raporti Financiar për vitin 2019

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, e paraqiti Raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, Raporti financiar për vitin 2019 për shkaqe që ne tashmë jemi në dijeni e që është situata e krijuar si pasojë e pandemisë, si pikë e rendit të ditës është shtyrë e që sipas ligjit është dashur të paraqitet në Kuvend më së largu deri më 31 mars 2020, mirëpo arsyet besoj të gjithë i dimë, kështu që tani e kemi proceduar në Kuvend edhe pse me vonesë paksa. Si zakonisht në këtë raport financiar janë paraqitur shpenzimet dhe të hyrat të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2019.

z.Mehmet Gashi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së theksoi, e kemi shqyrtuar raportin financiar për vitin 2019, dhe ne i përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, meqenëse materialin përkatës e kemi marrë të gjithë me kohë, por edhe Drejtori parafolës e paraqiti fjalën në pika të shkurtra dhe e potencoj se ka interesim për të na e sqaruar, andaj ne me qëllim që të mos përsërtien gjëra të ngjashme sot dhe nesër, e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për diskutim në mbledhjen e caktuar për nesër.

z.Avni Fetahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, edhe ne i rekomandojmë Kuvendit për diskutim.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, si pikë e rendit të ditës i rekomandojmë Kuvendit për diskutim në mbledhjen e radhës.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

2. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2019 në vitin 2020 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, e paraqiti propozim vendimin në fjalë, ndër të tjera theksoi, lidhur me propozim vendimin në fjalë, neni 9 i Ligjit për buxhetin e përcakton qartë se të gjitha të hyrat e Komunave, të cilat janë të inkasuara dhe të regjistruara në sistemin e menaxhimit të financave publike të Kosovës ato barten automatikisht në vitin aktual fiskal, kështu që ne këto të hyra të cilat kanë qenë të realizuara, dhe të pa shpenzuara i kemi propozuar që të barten në vitin aktual-2020 dhe atë sipas propozim vendimit të cilin e kemi para vetës.

Dëshiroj të potencoj që në mbledhjen e kaluar është miratuar një vendim me të cilin kemi marrë masa lehtësuese për luftimin e Covid-19, si dhe në të cilën figuron që nga disa Drejtori përkatës, përkohësisht tërhiqen mjete buxhetore buxhetit në shumë të përgjithshme 125,000,00€, në mënyrë që kur të vijnë të hyrat e bartura, ato mjete të kompensohen-rikthehen tek ato Drejtori, e që në realitet ashtu edhe kemi vepruar në këtë propozim për të cilin po diskutojmë, madje jo vetëm që rikthen por edhe ka rritje në ato kategori të drejtorive përkatëse sepse kemi pasë hapësirë dhe mundësi buxhetore, natyrisht që edhe kanë pasë nevojë që Drejtorive të caktuara t'iu rritet buxheti në fushat përkatëse, qoftë për ndihmë fermerëve, qoftë për ndihma njerëzve në nevojë, qoftë OJQ-ve, etj.

Pra edhe njëherë e përsërisë se kemi kompensuar mjetet e marra përkohësisht nga Drejtoritë përkatëse si dhe kemi propozuar plus buxhet shtesë për ato Drejtori.

z.Mehmet Gashi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së theksoi, theksoi, me vëmendje dëgjuam fjalën hyrëse të Drejtorit parafoles. Bartja e mjeteve nga viti paraprak është e drejtë ligjore që iu ka dhënë me Ligj komunave, kështu që ato mjete natyrisht që duhet të barten, andaj e mbështesim dhe rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e nesërme. Është e evidente që ato mjete kanë qenë të planifikuara për vitin e kaluar mirëpo projektet me siguri një pjesë nuk kanë mundur të përfundojnë, kështu që shumica e atyre mjeteve janë për projektet e vitit të kaluar që duhet të mbulohen me buxhet të nevojshëm sipas kontratave të nënshkruar, prandaj edhe e përkrahim si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së.

z.Avni Fetahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, LVV e rekomandon këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim në Kuvend ku edhe do t'i paraqesim vërejtjet dhe sugjerimet tona.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, edhe ne si Grup i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e nesërme.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim

3. Informatë lidhur me shpërndarjen e ndihmave me pako ushqimore dhe higjienike qytetarëve në nevojë, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0020192/20 të datës 02 prill 2020 dhe ndihmave tjera nga donatorë të ndryshëm.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

4. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, e paraqiti propozimin në fjalë, ndër të tjera theksoi, arsyeshmëria pse ky propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores në fjalë bëhet për qëllim të zbatimit të Rregullores bazë e cila është miratuar vitin e kaluar në Kuvend, përkatësisht pas miratimit të buxhetit për vitin 2020, andaj edhe si e tillë Rregullorja në fjalë ka implikime buxhetore, fillimisht së pari duhet t'i ketë dy periudha kohore, gjashtë mujore, pastaj një buxhet të garantuar që Komuna do të paguaj Kompanitë përkatëse për shërbimet e kryera, së dyti duhet të jetë një staf i shtuar i administratës kryesisht të sektorit të financave 3 deri 5 persona, së treti planifikimet me GIZ-in Gjerman të punohet në data bazë dhe në përvoja të komunave për stafin dhe për buxhetin si dhe për serverin e data-bazës e që gjatë kësaj periudhe kohore nuk kemi pas mundësi t'i bëjmë të gjitha këto.

Sigurisht që edhe Komuna e Podujevës ashtu sikurse komunat tjera edhe këtë vit mund të jetë e goditur nga të hyrat vetanake ngase kemi bërë dhe sigurisht se do të vazhdojmë me lehtësime të mëdha për qytetarët dhe bizneset, atëherë në fund të vitit nuk mund të garantohet që do të ketë të hyra të stabilizuara në mënyrë që të kemi së paku 200,000.00€ apo 250,000.00€, për start me pagesa të shërbimeve të tilla. Propozim Rregullorja bazë ende nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare të R Republikës së Kosovës, procedurë kjo e cila edhe mundëson fillimin e zbatimit të saj, andaj miratimi i propozim Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e saj nuk ndryshon asgjë nga Rregullorja bazë përveç caktimit-shtyrjes së afatit të datës së hyrjes në fuqi. Arsyeja pse e kemi marrë si muaj fillimin e prillit është sepse kemi llogaritur se kemi mundur ta bëjmë me 1 janar ose në shkurt apo mars, por meqë janë pagesat ose faturimin tre (3) mujor atëherë kemi thënë që të fillon në tre mujorin e dytë.

Aktualisht vetëm Komuna e Prishtinës është duke aplikuar, Komunat tjera ende nuk kanë avancuar, pastaj edhe Kompania KRM “Pastrimi” gjatë kësaj kohe është në dijeni lidhur me problemet që në fakt nuk kanë ndonjë mekanizëm të shtuar për këtë çështje, dua të them se ka një mori arsyes por arsyeja kryesore është se për faktin që kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023, si Ekzekutiv dhe si Kuvend duhet t’i marrim masat buxhetore dhe përgatitjet buxhetore së paku për gjashtë muajt e ardhshëm, pavarësisht të hyrave që do t’i kemi në gjashtë mujorin e parë e që sigurisht se nuk do ta kemi mundësi që qytetarët t’i përgjigjen të hyrave që do të jenë taksat dhe të hyrat tjera, pastaj mund të vëreni edhe problemet që kemi me tatimin në pronë, kështu që kisha kërkuar edhe nga ju sot po edhe nesër në Kuvend që të miratoni këtë ndryshim të datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Kryesuesi i Komitetit, falënderoj Drejtorin parafolës për sqarimet e dhëna, njëkohësisht kërkoj nga anëtarët e Komitetit të marrin fjalën nëse dëshirojnë, mirëpo meqë nuk pati të interesuar për të marrë fjalën, e vë në votim propozimin në fjalë.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi i Kuvendit, e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0022803/20

Podujevë,

21 maj 2020

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi